



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

---

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_/\_\_\_/2019

**V E N D I M**

**Nr. 81, Datë 01/07/2019**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 2, datë 07.01.2019, e Znj. L.K., ku pretendohet diskriminim, për shkak të “moshës”, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU), Tiranë dhe Drejtorisë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit<sup>1</sup>, Qarku Durrës.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjekteve ankuese.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, si dhe mbështetur në dokumentacionin bashkëlidhur, rezulton se Znj. L.K., e datëlindjes 19.02.1963, banuese ne Durrës, ka përfunduar studimet e larta pranë Universitetit të Tiranës, Dega Mercologji. Nga viti 1993, deri në muajin korrik të vitit 2010, ka punuar në Drejtorinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit Durrës. Në vijim, me krijimin e AKU-së, të Qarkut Durrës ka punuar në pozicionin e inspektorese së ushqimit dhe gëzon statusin e nëpunësit civil. Ankuesja shprehet se në muajin nëntor 2013 është caktuar Koordinatorë në Sektorin e Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë jo Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit. Znj. L.K. pretendon se ky funksion i është ngarkuar me Urdhër të Brendshëm të Drejtorit Rajonal, me qëllim koordinimin e punëve të sektorit, për të mos patur mbivendosje në raportime dhe në përpilimin e relacioneve për problematika të ndryshme. Ajo thekson faktin se ky pozicion nuk është i përcaktuar në organikën e institucionit.

Për sa më sipër, Znj. L.K. e informon Komisionerin se situata diskriminuese ndaj saj ka filluar me marrjen e masës disiplinore “mbajtje e 1/3 së pagës për një periudhë 3 mujore”, dhënë me Vendimin nr. 5682/7, datë 26.03.2018, e Komisionit Disiplinor të Autoritetit Kombëtar të

---

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën DRAKU Durrës;

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

Ushqimit. Ankuesja shprehet se vendimi është dhënë padrejtësisht ndaj saj, si dhe Komisioni Disiplinor nuk është ngritur në përputhje me përcaktimet përkatëse ligjore dhe nënligjore. Si i tillë, vendimi i tij është formalisht i pavlefshëm. Njëkohësisht, në inspektimet e kryera, Znj. L.K. ka qenë pjesë e ekipit të inspektimit. Ndaj saj është filluar procedimi disiplinor, ndërkohë që ndaj inspektorëve të tjerë që kanë qenë pjesë e ekipit të inspektimit, nuk është kryer një gjë e tillë. Për sa më sipër, ankuesja shprehet se e ka kundërshtuar vendimin e sipërpërmendur pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Nëpërmjet vendimit nr. 3480, datë 18.10.2018, të kësaj gjykate<sup>3</sup> është vendosur rrëzimi i kërkesëpadisë së ankueses për shfuqizimin e vendimit nr. 5682/7, datë 26.03.2018, të Komisionit Disiplinor të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.

Në vijim, ndaj ankueses është filluar sërish procedim disiplinor. Nëpërmjet shkresës nr. 891, datë 18.06.2018, “Vendim mbi shkelje të konstatuara ndaj Znj. L.K.”, të Drejtores (me autoritet të deleguar) të Drejtorisë Rajonale Durrës, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së, është vendosur kalimi i procedimit disiplinor dhe akteve të tij, për shqyrtim Komisionit Disiplinor, në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU-së. Nëpërmjet Urdhërit nr. 4285/1, datë 16.07.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të AKU-së është ngritur Komisioni Disiplinor, për shqyrtimin e shkeljeve disiplinore të kryera nga ankuesja, në referencë të nenit 57, pika 2, gërmat a) dhe c) të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar). Ankuesja është njoftuar me shkresën nr. 4285/2, datë 16.07.2018, mbi fillimin e procedimit disiplinor për shkelje shumë të rënda disiplinore. Komisioni Disiplinor ka dalë me konkluzionet përkatëse në Vendimin nr. 4285/5, datë 03.09.2018, nëpërmjet së cilit ka vendosur marrjen e masës disiplinore *‘largim nga shërbimi civil’* për ankuesen. Mbështetur në vendimin e mësipërm, me anë të Urdhërit nr. 4285/6, datë 03.09.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të AKU-së është vendosur që Znj. L.K., me pozicion “inspektor” në Sektorin e Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Jo Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit, pranë Drejtorisë Rajonale të AKU-së, Qarku Durrës, t’i ndërpriten marrëdhëniet e punës dhe ato financiare, duke filluar nga data 10.09.2018. Znj. L.K. shprehet sërish se nga ana formale dhe procedurale, ngritja e Komisionit Disiplinor nuk është kryer në përputhje me aktet nënligjore përkatëse, si dhe jep kundërshtimet e saj, në lidhje me shkeljet e konstatuara. Ankuesja e ka bërë me dije KMD-në se ajo e ka kundërshtuar këtë vendim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe kjo e fundit e ka rrëzuar kërkesëpadinë e saj. Ndërkohë që, ankuesja pretendon se e ka apeluar këtë vendim pranë Gjykatës së Apelit Administrativ. Znj. L.K. thekson faktin se Komisioni Disiplinor sërish është ngritur në kundërshtim me dispozitat e akteve ligjore e nënligjore, si dhe ajo ka mbajtur përgjegjësi individuale, mbi inspektime të cilat janë kryer nga ekipe inspektimi, të përbërë nga disa inspektorë.

Përveç sa më sipër, ankuesja pretendon se nga data 01.06.2018, deri në datën 31.08.2018, ka kryer inspektime në ditët e fundjavës, në subjekte të ndryshme dhe ajo ka qenë e vetmja inspektore femër<sup>4</sup>, nga të gjitha inspektorët e tjera femra në këtë institucion, që ka punuar gjatë

<sup>3</sup> Vendimi në fjalë është i formës së prerë.

<sup>4</sup> Për këtë pretendim të parashtruar, pavarësisht se nuk është shprehur nga ankuesja, Komisioneri gjykon se “gjinia” duhet të merret si shkak diskriminimi.

këtyre fundjavave bashkë me inspektorët meshkuj. Ankuesja pretendon se Autorizimet për inspektim protokolloheshin në ditët e premte dhe inspektimet kryheshin të shtunave dhe të dielave. Për sa më sipër, Znj. L.K. shprehet se DRAKU nuk ia ka paguar orët e punës jashtë orarit, gjatë kësaj periudhë kohore.

Ankuesja L.K. shprehet se është diskriminuar për shkak të moshës së saj, pasi ajo është inspektorja me moshë më të madhe në sektorin, ku ajo punon, Ajo shprehet se të gjithë inspektorët e tjerë janë të rinj në moshë dhe pikërisht masat e marra ndaj saj janë kryer pikërisht për ta diskriminuar për shkak të moshës së saj.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 2, datë 07.01.2019, e Znj. L.K., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

Mbështetur në nenin 33, pika 7<sup>5</sup>, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Drejtorisë së Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU), Tiranë dhe Drejtorisë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (DRAKU), Qarku Durrës, me shkresën nr. 16/1, datë 23.01.2019, ku kërkohej informacion, si më poshtë vijon:

- Urdhëri/at e emërimit në detyrën e inspektore, së Znj. L.K.;
- Urdhërin e emërimit të ankuses, në pozicionin e Koordinatorës pranë Drejtorisë Rajonale të AKU-së Durrës;
- Kopje të përshkrimit të punës të inspektore në Sektorin e Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Jo Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit, pranë Drejtorisë Rajonale të AKU-së, Qarku Durrës;
- Kopje e përshkrimit të punës për pozicionin e Koordinatorës për Sektorin e sipërpërmendur;
- Kopje e strukturës organizative të Drejtorisë Rajonale të AKU-së, Qarku Durrës;
- Kopje të të gjitha masave disiplinore të dhëna për ankuesen, që nga momenti i punësimit të saj pranë Drejtorisë Rajonale të AKU-së, Qarku Durrës;
- Kopje të të gjitha vlerësimeve në punë të ankuses;
- Kopje e librezës së punës dhe diplomës së shkollës së lartë të ankuses;

---

<sup>5</sup> Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

- Kopje të vendimeve gjyqësore të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë/Apelit, lidhur me proceset gjyqësore, në të cilat Drejtoria Rajonale e AKU-së Durrës dhe Drejtoria e Përgjithshme e AKU-së, Tiranë kanë qenë palë e paditur nga ankuesja dhe anasjelltas;
- Informacion, nëse ankuesja ka paraqitur observacionet e saj, ku kundërshtohet dhënia e masës disiplinore për largimin nga shërbimi civil dhe mënyrën se si është reflektuar nga Drejtoria e Përgjithshme e AKU-së mbi to;
- Informacion mbi faktin, nëse janë proceduar disiplinarisht, si dhe dhënë masa disiplinore ndaj inspektorëve të tjerë, që kanë qenë në grup inspektimi në ankuesen, në ato inspektime që kanë rezultuar me shkelje ndaj subjekteve të caktuara dhe si rrjedhim i së cilave ankuesja është larguar nga shërbimi civil. Nëse po, të dërgohen aktet përkatëse, ku të rezultojnë masat e dhëna ndaj tyre;
- Lista emërore e inspektorëve që punojnë në të njëjtën drejtori/sector me ankuesen, ku të reflektohet mosha e tyre;
- Autorizimet përkatëse të inspektimeve, si dhe procesverbalet e inspektimit për periudhën 01.06.2018, deri në datën 31.08.2018. Arsytet e caktimit të Znj. L.K. në inspektimet e kryera gjatë kësaj periudhe kohore, ndërkohë që inspektorët e tjera femra nuk përfshiheshin në to;
- Informacion, nëse ankueses i janë paguar orët jashtë orarit për inspektimet e kryera në fundjave, si dhe urdhrat e titullarëve përkatës, nëpërmjet së cilëve është vendosur që inspektimet të kryhen gjatë ditëve të pushimit për periudhën e sipërmendur;
- Praktika e plotë e procesimit disiplinor për largimin nga shërbimi civil të ankueses;

1. Në përgjigje të shkresës nr. 16/1, datë 23.01.2019, të Komisionerit, Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (DRAKU), Qarku Durrës, dërgoi shkresën nr.16/2, datë 06.02.2019, nëpërmjet së cilës e informon Komisionerin se Znj. L.K. ka qenë nëpunës civil i kategorisë ekzekutive, në pozicionin inspektorë në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshë me Origjinë Joshtazore (OJSH) dhe operatorëve të biznesit (OBU) në Drejtorinë Rajonale të Autoritetit Kombëtar Ushqimor (DRAKU), Qarku Durrës.

Në shkresën e sipërmendur sqarohet se me anë të Vendimit nr. 5682/7 Prot., datë 26.03.2018, Komisioni Disiplinor ka marrë masën disiplinore *“mbajtje e 1/3 të pagës për një periudhë 3 mujore”*, ndaj Znj. L.K.. DRAKU, Durrës thekson faktin se për përcaktimin e masës së zbatueshme në vendimin e sipërcituar, është respektuar parimi i proporcionalitetit, duke kryer një riklasifikim të shkeljes së kryer nga *“shkelje shumë të rënda disiplinore”*, në *“shkelje të rënda disiplinore”*.

Ndërkohë që, DRAKU, Durrës e bën me dije KMD-në së nëpërmjet Vendimit nr. 4285/5, datë 03.09.2018, Komisioni Disiplinor ka marrë masën disiplinore *“largim nga shërbimi civil”* ndaj Znj. L.K..

Vendimet e sipërcituara të Komisionit Disiplinor janë lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe Durrës.

Lidhur me inspektimet gjatë sezonit turistik, në shkresën e DRAKU, Qarku Durrës, sqarohet se, këto inspektime janë kryer në zbatim të Urdhërit nr. 07, datë 30.04.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të AKU-së. Në këtë Urdhër përcaktohet se për shkak të inspektimeve, si dhe për të përballuar fluksin e rritur të kontrolleve në të gjitha subjektet, veçanërisht të vijës bregdetare, inspektorët do të punojnë edhe gjatë ditëve të shtuna dhe të djela, si dhe jashtë kohës normale të punës (*pika 8, e Urdhërit nr. 07, datë 30.04.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të AKU-së*). Për inspektimet që do të kryhen ditët e pushimeve, por edhe jashtë kohës normale të punës, do të këtë urdhër të veçantë nga Drejtori Rajonal, duke përcaktuar specifikisht inspektorët dhe subjektet që do të inspektohen (*pika 9, e Urdhërit nr. 07, datë 30.04.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të AKU-së*).

Në zbatim të urdhërit të mësipërm, inspektimet janë kryer në bashkëpunim ndërmjet sektorit OJSH dhe OSH të DRAKU Durrës dhe grupet e inspektimit koordinoheshin çdo javë. Lidhur me orët e punës të kryera jashtë orarit zyrtar, DRAKU Durrës ka zbatuar parashikimin e pikës 5, Kreu I, të Vendimit nr. 511, datë 24.10.2002, të Këshillit të Ministrave, "*Për kohëzgjatjen e punës dhe pushimit në institucionet shtetërore*" (të ndryshuar).

Lidhur me pretendimin e ankueses se ajo ka qenë e vetmja inspektore femër, që është caktuar në grupin e inspektimit, DRAKU Durrës sqaron se edhe në inspektimet e përditëshme, ajo ka qenë e vetmja inspektore femër në sektorin e saj, pasi Sektori i Inspektimit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshë me Origjinë Joshtazore dhe Operatorët e Biznesit ka në përbërje të tij 4 inspektore femra, ndër të cilat një inspektore femër ka qenë me leje lindjeje, një inspektore tjetër ka qenë e ngarkuar me punë pranë Sektorit të Shërbimeve të Brendshme, në zbatim të Urdhërit nr. 109/3, Prot., datë 06.02.2017, të Drejtorit të DRAKU Durrës, si dhe inspektorja e tretë femër ka qenë e ngarkuar pranë Sektorit të Shërbimeve Laboratorike, nëpërmjet Urdhërit nr. 426 prot., datë 06.03.2018, të Drejtorit të DRAKU Durrës.

Lidhur me masat disiplinore të dhëna për inspektorë të tjerë, në shkresën e DRAKU Durrës sqarohet se referuar legjisllacionit në fuqi, eprori direkt kryesisht ose nëpërmjet ankesave të pretenduara bën vlerësimin e shkeljeve disiplinore me faj, të pretenduara përkundrejt nëpunësit civil dhe i klasifikon ato. Vetëm pas një hetimi të plotë administrativ eprori direkt kryen vlerësimin e shkeljeve të pretenduara. Për sa më sipër, janë ndërmarrë masa disiplinore edhe për inspektorët D. Z., A.B., M.C., D. D.

Në shkresën nr.16/2, datë 06.02.2019, e DRAKU Durrës përmendet edhe çështja e moskryerjes së dorëzimeve nga ana e Znj. L.K., pas largimit të saj nga shërbimi civil, nëpërmjet Urdhërit nr.4285/6, datë 03.09.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të AKU-së. Referuar pikës 2, të urdhërit të mësipërm, Znj. L.K. duhet të kishte kryer dorëzimet përkatëse brenda datës 11.09.2018, në kushtet kur largimi nga shërbimi civil është kryer në datën 07.09.2018.

Për sa më sipër, rezulton se ankuesja nuk e ka kryer dorëzimin e punës së saj, në kundërshtim, jo vetëm me urdhërin e sipërpërmendur, por edhe me parashikimet e pikës 27, të Vendimit nr. 124, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, *“Për pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”*.

Duke konstatuar mospërmbushje të parashikimeve të mësipërme nga ana e Znj. L.K., DRAKU Durrës i është drejtuar ankueses, nëpërmjet shkresës nr. 1373, datë 19.09.2018, duke përcaktuar si afat për kryerjen e dorëzimeve, datën 24.09.2018, afat i cili sërisht nuk është zbatuar nga ankuesja. Për dorëzimin e praktikave të inspektimit, Znj. L.K. ka kërkuar nga ana e DRAKU Durrës, përgatitjen/draftimin e procesverbalit të dorëzimit, sipas citimeve të saj, mbi të dhënat e praktikave përkatëse, në mënyrë që ajo thjesht të nënshkruante.

Në shkresën e tij, DRAKU Durrës thekson faktin se pavarësisht se kjo kërkesë ishte absurd, u pranua dhe u përgatiti procesverbali i dorëzimit të praktikave të kryera nga Znj. L.K. dhe firmosja e tij u bë në datën 08.10.2018, ndërmjet saj dhe titullarit të DRAKU Durrës.

Në datën 08.10.2018, Znj. L.K. i është kërkuar dorëzimi i bazës materiale që kishte në ngarkim, sipas kartelës së inventarit të fundvitit 2017. Ky dorëzim nuk u krye, pasi Znj. L.K. nuk e dispononte të gjithë bazën materiale që kishte në ngarkim. Në vijim, DRAKU Durrës sërisht iu drejtua ankueses me shkresën nr. 1373/1, datë 02.11.2018, duke përcaktuar afat për kryerjen e dorëzimeve, por ankuesja edhe pse mori dijeni për këtë shkresë (verifikuar nga lajmërim marrja përkatëse), ky afat sërisht nuk u respektua nga ana e saj.

DRAKU Durrës e bën me dije KMD-në, se ankuesja në cilësinë e Koordinatorës së Sektorit OJSH, ka përgatitur të gjitha informacionet e kërkuara nga DRAKU dhe Drejtori Rajonal. Këto dokumente nuk janë dorëzuar nga ana e saj dhe nuk janë konstatuar as nga ana e Komisionit të Inventarizimit, që ka qenë prezent në zyrën e saj. Një gjë e tillë dëshmon se dokumentacioni i institucionit është nxjerrë jashtë DRAKU Durrës, nga ana e Znj. L.K.

Në shkresë theksohet fakti se DRAKU Durrës ka respektuar çdo procedurë duke tejkaluar çdo parashikim ligjor.

Lidhur me çështjen e observacioneve të dorëzuara nga Znj. L.K., mbi masën disiplinore të dhënë ndaj saj për largim nga shërbimi civil dhe mbi mënyrën se si është reflektuar nga ana e këtij institucioni, DRAKU Durrës shprehet se mbështetur në informacionin e dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e AKU-së, Znj. L.K. ka paraqitur observacione në seancë dëgjimore, për të cilat Komisioni Disiplinor në arsyetimin e Vendimit nr. 4285/5, datë 03.09.2018, i ka kthyer përgjigje të gjitha pretendimeve të shprehura në observacionet përkatëse. Gjithashtu është mbajtur procesverbali përkatës me nr. 4285/5, datë 23.07.2018, i cili është dërguar në cilësinë e provës pranë KMD-së.

Lidhur me çështjen e emërimit të Znj. L.K. në pozicionin e Koordinatorit, DRAKU Durrës sqaron se ky pozicion nuk bën pjesë në organikën e këtij institucioni. Ky pozicion rregullohet me një vendim të titullarit të institucionit, por gjithnjë me pëlqimin e punonjësit përkatës. Në

arshivën e institucionit të DRAKU Durrës nuk është gjendur një dokument i brendshëm për caktimin e Znj. L.K. në këtë pozicion.

DRAKU Durrës dërgoi bashkëlidhur shkresës së tij edhe kopje të dokumentacionit të kërkuar nga Komisioneri, lidhur me masat disiplinore të dhëna ndaj Znj. L.K. dhe inspektorëve të tjerë, përshkrimin e punës së ankueses për pozicionin e punës inspektore në Sektorin e inspektimit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë me origjinë jo shtazore (OJSH) dhe operatorëve të biznesit (OBU). Njëkohësisht, DRAKU Durrës dërgoi bashkëlidhur shkresës së tij edhe një kopje të strukturës organizative, listën e inspektorëve që punojnë në një drejtori/sektor me ankuesen, ku ndër të tjera reflektohet mosha e tyre. Sipas këtij dokumenti rezulton se pranë Sektorit punojnë këta inspektorë:

<b>Sektorin e Inspektimit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshë me OJSH dhe Operatorëve të Biznesit/DRAKU Durrës</b>				
<b>Nr.</b>	<b>Inspektorë</b>	<b>Ditëlindja</b>	<b>Profesioni</b>	<b>Data e emërimit</b>
1.	E. C.	15.04.1980	Kimi ushqimore	01.09.2010
2.	A. Gj.,(K.)	29.11.1984	Biologji Kimi	11.07.2011
3.	D. Z.	05.06.1988	Inxhinieri e proceseve kimike	25.07.2014
4.	L.K.	19.02.1963	Mercolog	01.07.2010
5.	M. B.	14.03.1968	Mercolog	19.12.2013
6.	A. B.	07.05.1990	Teknologji agroushqimore	17.02.2014
7.	D. D.	09.12.1985	Agrobiznes	22.11.2013
8.	E. Xh.	15.09.1990	Biologji molekulare dhe mjedisore	27.07.2015

Lidhur me vlerësimet e punës ndër vite për Znj. L.K., DRAKU Durrës shprehet se këto akte do të dërgohen në një moment të dytë, pasi nuk disponohen nga ky institucion, por nga Drejtoria e Përgjithshme e AKU-së Tiranë. Në bazë të database-s së administruar nga DRAKU Durrës, vlerësimet për ankuesen janë: Vlerësim vjetor 2013-2014 – 1; vlerësim vjetor 2015 – 1, vlerësim vjetor 2016 – 1; vlerësim për periudhën janar-qershor 2017 – 1, vlerësim për periudhën Korrik-Dhjetor 2017 – 2; vlerësim për periudhën janar-qershor 2018 – 3.

Në shkresën e DRAKU Durrës sqarohet se pranë institucionit të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit nuk është dërguar ende kopja e zbardhur e vendimeve përkatëse nga ana e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë apo Durrës, por në momentin që do të disponohen këto vendime do të dërgohen pranë KMD-së në cilësinë e provës.

9. Në vijim të shkresës nr.16/2, datë 06.02.2019, DRAKU Durrës dërgoi shkresën nr. 190/2, datë 27.02.2019, në adresë të Komisionerit. Bashkëlidhur kësaj shkresë janë përcjellë vlerësimet e punës së Znj. L.K..

10. Ndërkohë, Znj. L.K. iu drejtua Komisionerit me disa e-maile, nëpërmjet së cilave dha informacion mbi çështjen në shqyrtim.

**B.** Në vijim të ndjekjes së procedurave të shqyrtimit administrativ, palët u njoftuan për seancë dëgjimore, e cila u vendos të realizohej në datën 12.04.2019, ora 11:00, pranë Zyrës së KMD-së.

Në këtë seancë dëgjimore u paraqit ankuesja L.K., si dhe Z. M.J., Drejtor i DRAKU Durrës dhe Znj. A.D., përfaqësuese e Drejtorisë së Përgjithshme të AKU Tiranë. Ankuesja L.K. u paraqit dhe largua pa filluar ende seanca dëgjimore, duke mos dhënë asnjë shpjegim për veprimin e saj. Pavarësisht këtij fakti, seanca u realizua në mungesë të saj. Përfaqësuesit e DRAKU Durrës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të AKU Tiranë u shprehën se ndaj Znj. L.K. nuk ishte ndërmarrë asnjë veprim diskriminimues, për shkak të moshës, apo qoftë edhe për ndonjë lloj shkak tjetër. Me anë të Vendimit nr. 5682/7 Prot., datë 26.03.2018, Komisioni Disiplinor ka marrë masën disiplinore “mbajtje e 1/3 të pagës për një periudhë 3 mujore”, ndaj Znj. L.K.. Ky vendim është lënë në fuqi me vendim të formës së prerë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Njëkohësisht, nëpërmjet Vendimit nr. 4285/5, datë 03.09.2018, Komisioni Disiplinor ka marrë masën disiplinore “largim nga shërbimi civil”, ndaj Znj. L.K., si pasojë e shkeljeve të konstatuara. Edhe ky vendim i Komisionit Disiplinor është lënë në fuqi me vendim të gjykatës administrative të shkallës së parë Durrës, ndërkohë që çështja është ankimuar nga Znj. L.K. pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

Të pyetur në lidhje me ekzistencën e pozicionit të Koordinatorit, pranë DRAKU Durrës, përfaqësuesit e pranishëm në seancë u shprehën se ky ishte një pozicion, i cili nuk ishte i përcaktuar në strukturën organike të DRAKU-t Durrës, si dhe nuk ekziston asnjë urdhër i brendshëm i Drejtorit të DRAKU-t Durrës, për të emëruar nominalisht Znj. L.K. si koordinator të inspektorëve. Koordinatori ka qenë një pozicion i krijuar në fillesat e institucionit, por që prej 5 vitesh nuk ekziston më si i tillë në strukturën organike. Përfaqësuesit e KMD-së iu kërkuan përfaqësuesve të DRAKU Durrës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të AKU Tiranë, që të përcillej një kopje e vendimit gjyqësor të Gjykatës Administrative të Apelit, në momentin që ky vendim për çështjen e ankimuar nga Znj. L.K., do të shpallej nga kjo instancë gjyqësore.

**I. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

**A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë.**



Autoriteti Kombëtar i Ushqimit është një institucion i administratës publike, i cili funksionon në bazë të parashikimeve të Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin” (i ndryshuar) dhe Vendimit nr. 1081, datë 21.10.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e AKU” (i ndryshuar).

Referuar pikës 2, të VKM-së së sipërpërmendur, AKU-ja organizohet në Drejtorinë e Përgjithshme, në nivel qendror, dhe drejtoritë rajonale, në çdo qark të vendit.

Mbështetur në pikën 6, të këtij Vendimi, Drejtoritë Rajonale të AKU-së drejtohen nga Kryeinspektori Rajonal dhe kryejnë këto funksione: a) Kontrollin paraprak<sup>6</sup>, për të vërtetuar nëse janë plotësuar kërkesat tekniko-teknologjike, higjieno-sanitare, fitosanitare dhe veterinare, verifikimin e dokumentacionit të nevojshëm për regjistrimin dhe liçensimin e operatorëve të biznesit ushqimor, ushqimit për kafshë, shëndetit të kafshëve dhe mbrojtjes së bimëve; b) Kontrollin zyrtar të ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë, si dhe në fushën e mbrojtjes së bimëve në territorin e qarkut përkatës; c) Kontrollin zyrtar të ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë, mbrojtjes së bimëve dhe në njësitë e inspektimit kufitar; ç) Mbledhjen e informacionit në fushën e sigurisë së ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë, mbrojtjes së bimëve dhe përcjelljen e tij në Drejtorinë e Përgjithshme; d) Ndalojnë, përkohësisht ose në mënyrë të përhershme, veprimtarinë e operatorëve të biznesit të ushqimit dhe të atij të ushqimit për kafshë në fazat e prodhimit, përpunimit, shpërndarjes dhe tregtimit të ushqimit apo ushqimit për kafshë, kur vërtetohet se ushqimi a ushqimi për kafshë dhe operatorët përkatës të biznesit nuk plotësojnë standardet e sigurisë ushqimore, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi etj.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se roli dhe kompetencat e AKU-së dhe Drejtorive Rajonale të AKU-së janë tepër të rëndësishme në drejtim të garantimit të sigurisë ushqimore të qytetarëve shqiptarë në të gjithë territorin e vendit. Në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson se mënyra se si kryhet detyra nga ana e inspektorëve të Drejtorive Rajonale, përgjegjshmëria, rigoziteti dhe përkushtimi i tyre në kryerjen e këtyre detyrave, ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në shëndetin e shtetasve shqiptarë.

Mbështetur në pikën IV/2, të Vendimit nr. 1081, datë 21.10.2009, të Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e AKU” (i ndryshuar), rekrutimi i punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme dhe të Drejtorive Rajonale të AKU-së, bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”<sup>7</sup>.

Lidhur me ankesën e depozituar pranë Komisionerit, nga Znj. L.K., rezulton se ankuesja ka punuar në pozicionin e inspektore në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për

<sup>6</sup> Referuar shprehimisht pikës 6, të Vendimit nr. 1081, datë 21.10.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e AKU” (i ndryshuar).

<sup>7</sup> Aktualisht ligji në fjalë është i shfuqizuar dhe statusi i nëpunësit civil rregullohet nëpërmjet Ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar);

Kafshë me Origjinë Jo Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit në Drejtorinë Rajonale të AKU-së, Qarku Durrës. Referuar akteve të dorëzuara në cilësinë e provës pranë Komisionerit, rezulton se ankuesja ka punuar në pozicionin e sipërpërmendur pranë DRAKU Durrës, që prej vitit 2010.

Çështja e parashtruar nga ankuesja L.K. konsiston në pretendimin për diskriminim për shkak të moshës, nga ana e DRAKU Durrës dhe Drejtoria e Përgjithshme e AKU-së Tiranë, lidhur me 4 nën-çështje, ku e para konsiston në dhënien e masës disiplinore “*mbajtje e 1/3 së pagës për një periudhë 3 mujore*”, nëpërmjet Vendimit nr. 5682/7, datë 26.03.2018, të Komisionit Disiplinor të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit. Nën-çështja e dytë konsiston në faktin e dhënies së masës disiplinore “*largim nga shërbimi civil*”, nëpërmjet Vendimit nr. 4285/5, datë 03.09.2018, të Komisionit Disiplinor. Ankuesja pretendon se të dyja këto masa disiplinore të dhëna nga Komisioni Disiplinor i Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së, konsistojnë në ndërmarrjen e veprimeve disfavorizuese, të pabarabarta dhe të padrejta ndaj saj, për shkak të moshës.

Njëkohësisht, ankuesja ngre pretendim për diskriminim edhe për dy nën çështje të tjera, që lidhen me kryerjen e inspektimeve jashtë orarit zyrtar dhe në ditët e pushimit gjatë fundjavës, përgjatë periudhës turistike, pranë subjekteve të ndryshme, si dhe për faktin që në inspektime të tilla ajo ka qenë e vetmja inspektore femër, që ka marrë pjesë në grupet e inspektimit.

**I.** Lidhur me çështjen e parë, të parashtruar nga ankuesja, e cila konsiston në dhënien e masës disiplinore “*mbajtje e 1/3 së pagës për një periudhë 3 mujore*”, nëpërmjet Vendimit nr. 5682/7, datë 26.03.2018, të Komisionit Disiplinor të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, ankuesja shprehet se vendimi është dhënë padrejtësisht ndaj saj, si dhe Komisioni Disiplinor nuk është ngritur në përputhje me përcaktimet përkatëse ligjore dhe nënligjore.

Nga analizimi i akteve të depozituara nga palët në këtë proces administrativ, rezulton se eprorët e Znj. L.K. kanë konstatuar mospërbushje të detyrave në përputhje me ligjin, lidhur me inspektimet e kryera në dy raste, si dhe në lidhje me mos kryerjen e raportimeve ditore për punën e kryer nga ana e saj. Në këto kushte, me Vendimin nr. 5682, datë 22.12.2017, eprori direkt i ankueses ka vendosur kalimin e procedimit disiplinor dhe akteve shoqëruese pranë Komisionit Disiplinor, me qëllim shqyrtimin e shkeljeve të kryera nga Znj. L.K..

Me Urdhërin nr. 5682/1, datë 08.02.2017, të titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së, Tiranë, është ngritur Komisioni Disiplinor ndaj nëpunëses civile L.K., me detyrë inspektore, në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Jo Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit në Drejtorinë Rajonale të AKU-së, Qarku Durrës.

Nëpërmjet shkresës nr. 5682/2, datë 08.02.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të AKU-së, Znj. L.K. është njoftuar për datën e zhvillimit të seancës dëgjimore. Me e-mailin e datës 14.02.2018, të Përgjegjësës së Sektorit të Burimeve Njerëzore, ankuesja është njoftuar për shtyrjen e kësaj seance. Me Urdhërin nr. 5682/3, datë 12.02.2018, është kryer një ndryshim në përbërjen e Komisionit Disiplinor, ku është zëvendësuar eprori direkt i ankueses dhe me shkresën nr. 5682/2, datë 12.02.2018, drejtuar Departamentit të Administratës Publike, është përcjellë kërkesa për

caktim përfaqësuesi. Në datën 19.02.2018 është mbajtur seance dëgjimore ndaj Znj. L.K., nga ku është mbajtur procesverballi nr. 5682/5, datë 19.02.2018. Në datën 26.03.2018 është mbajtur seanca e votimit të fshehtë nga anëtarët e Komisionit Disiplinor, mbi ecurinë disiplinore në ngarkim të ankueses, nga ku është mbajtur edhe procesverballi nr. 5682/6, datë 26.03.2018.

Në vijim, Komisioni Disiplinor i AKU-së është shprehur me Vendimin nr. 5682/7, datë 26.03.2018, ku ka vendosur marrjen e masës disiplinore “*mbajtje e 1/3 së pagës për një periudhë 3 mujore*”, të cilin ankuesja e ka paditur gjyqësisht pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ku ka kërkuar shfuqizimin e këtij vendimi.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë është shprehur me vendimin nr. 3480, datë 20.07.2018, nëpërmjet së cilit ka rrëzuar kërkesëpadinë e ankueses. Ky vendim është i formës së prerë.

Për të arritur në përfundimin e konstatimit të diskriminimit, për shkakun e pretenduar nga ankuesja, Komisioneri identifikon dhe vërteton paraprakisht, nëse ajo është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë e disfavorizues nga ana e DRAKU Durrës dhe Drejtoria e Përgjithshme e AKU-së Tiranë. Në kushtet kur, me vendim gjyqësor të formës së prerë është vendosur mbajtja në fuqi e Vendimit nr. 5682/7, datë 26.03.2018, të Komisionit Disiplinor të AKU-së, Komisioneri gjykon se në kuptim të nenit 7, pika 1, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ankuesja nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë e disfavorizues. Në mungesë të këtij trajtimi të tillë, nuk ekziston diskriminim i Znj. L.K., për shkakun e pretenduar, në lidhje me masën disiplinore të dhënë nëpërmjet Vendimit nr. 5682/7, datë 26.03.2018, të Komisionit Disiplinor, ku është vendosur “*mbajtje e 1/3 së pagës për një periudhë 3 mujore*”.

**II.** Nën-çështja e dytë, e pretenduar nga ankuesja L.K., si diskriminues, konsiston në dhënien e masës disiplinore “*largim nga shërbimi civil*”, nëpërmjet Vendimit nr. 4285/5, datë 03.09.2018, të Komisioni Disiplinor.

Për sa më sipër, rezulton se, në mbështetje të Raportit Përfundimtar të Grupit Auditues të Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së nr. 581/15 prot., datë 11.06.2018, për periudhën 01 Prill 2016 deri më 31 Dhjetor 2017, në lidhje me verifikimin e përputhshmërisë ligjore për procedurat e inspektimit, të ndjekura gjatë kryerjes së veprimtarisë inspektuese nga inspektorët e DRAKU Durrës, nga kontrolli i praktikave të inspektimit ndaj paditëses, janë konstatuar shkelje disiplinore shumë të rënda të kryera nga Znj. L.K..

Shkeljet e evidentuara nga DRAKU Durrës, lidhen me “*mospërbushjen e rëndë të detyrave funksionale*” dhe “*moszbatimin haptazi të dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale*”, të parashikuara nga neni 57, pika 2, gërmat “a” dhe “c”, të Ligjit nr. 152/2013, “Për Nëpunësin Civil”, (i ndryshuar), të cilat klasifikohen si shkelje shumë të rënda, që sjellin pasoja shumë të rënda në aspektin e cënimit të sigurisë ushqimore.

Me Vendimin nr. 891 prot., datë 16.06.2018, të Drejtorit të DARKU Durrës, është vendosur për kalimin e akteve për shqyrtim në Komisionin Disiplinor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së, pasi në zbatim të pikës 10, të Kreut II, “Procedura Disiplinore”, të Vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil”*, shkeljet e Znj. L.K., që konsistojnë në mospërbushjen e rëndë të detyrave dhe moszbatimit haptazi të dispozitave ligjore, për përbushjen e detyrave funksionale, klasifikohen si shkelje shumë të rënda disiplinore, për rrjedhojë nuk janë në kompetencën e eprorit direkt, por në kompetencën lëndore të Komisionit Disiplinor.

Në vijim, Komisioni Disiplinor është ngritur me Urdhërin nr. 4285/1 prot., datë 16.07.2018, e Drejtorit të Përgjithshëm të AKU-së, për shqyrtimin e shkeljeve të mësipërme. Me shkresën nr. 4285/2 prot., datë 16.07.2018, është kryer njoftimi i ankueses dhe me shkresën nr. 4285/3 prot., datë 16.07.2018 është kryer njoftimi i Departamentit të Administratës Publike, për caktimin e një përfaqësuesi në seancën dëgjimore të datës 23.07.2018, që do të zhvillohej me ankuesen L.K., në të cilën ankuesja u dëgjua dhe parashtrou kundërshtimet e saj.

Pas shqyrtimit të materialit përkatës, me Vendimin nr. 4285/5, datë 03.08.2018, e Komisionit Disiplinor të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, për Znj. L.K. është marrë masa disiplinore *“Largim nga Shërbimi Civil”*.

Referuar Vendimit të sipërpërmendur rezulton se mbështetur në Raportin Përfundimtar nr. 581/15 Prot., datë 11.06.2018, të Grupit Auditues të Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së, për periudhën 01 prill 2016 deri më 31 dhjetor 2017, në lidhje me verifikimin e përputhshmërisë ligjore për procedurat e inspektimit, të ndjekura gjatë kryerjes së veprimtarisë inspektuese nga inspektorët e DRAKU Durrës, nga kontrolli i praktikave të inspektimit janë konstatuar shkelje disiplinore shumë të rënda, të cilat përbëjnë shkak për fillimin e ecurisë disiplinore për Znj. L.K..

Në pjesën e argumentimit ligjor të vendimit të sipërpërmendur, Komisioni Disiplinor ka konstatuar 4 raste, ku janë evidentuar një sërë shkeljesh. Njëri prej këtyre rasteve konsiston edhe në kryerjen e një inspektimi, mbështetur në Autorizimin nr. 803, datë 17.09.2017, pranë subjektit Kamelja 3, me aktivitet Restorant, me adresë Shkëmbi i Kavajës, Bashkia Durrës. Ky inspektim është kryer mbi bazën e një denoncimi. Në Vendim citohet: *“Në praktikën e inspektimit, ndodhet një procesverbal, i cili përshkruan se mbi bazën e njoftimit të marrë nga specialistët e shëndetit publik dhe më pas konfirmuar edhe nga spitali i qytetit të Durrësit rezulton se janë shtruar në spital rreth 15 persona me intoksikim. Kjo situatë intoksikimi, pretendohej se kishte ardhur nga konsumi i disa produkteve në restorantin Kamelja 3, në adresë Shkëmbi i Kavajës. Grupi i inspektimit ka shkuar në subjekt dhe ka marrë mostra nga ushqimet e pretenduara të konsumuara nga personat e helmuar. Grupi i inspektimit ka marrë edhe mostra nga produktet e pretenduara të konsumuara dhe ato që ishin gjendje. Situata e mësipërme është përshkruar me anë të një procesverbali të mbajtur më datën 17.09.2017 dhe njëkohësisht edhe me anë të*

*procesverbalit të inspektimit. Nga procesverbali konstatohet se së pari ora e fillimit të inspektimit dhe mbarimit është korrigjuar. Në një kohë që ka shkelje të kushteve higjieno-sanitare, në Rubrikën e planit HACCP, thuhet se subjekti zbaton praktikat e mira të higjenës dhe në një rubrikë tjetër zbaton praktikat e mira të punës, pra evidentohet qartazi kontradikta midis dy rubrikave të të njëjtit procesverbal lidhur me konstatimin e përshkruar dhe vlerësimit të mëposhëm, për sistemin e vetëkontrollit. ....*

Për sa më sipër, është theksuar fakti se bazuar në raportin auditues të Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së, mbi bazën e të cilit, ka filluar dhe ecuria disiplinore, janë provuar disa shkelje lidhur me inspektimin pranë subjektit Kamelja 3. Në Vendim theksohet fakti se në lidhje me rastin e sipërcituar Prokuroria e Rrethit Gjirokastrë Durrës më anë të shkresës nr. 2977 prot., datë 13.10.2017, i ka kërkuar AKU-së vlerësimin për marrjen e masave administrative nga ana e inspektorëve të saj, shkresë, mbi të cilën nëpunësi L.K. ka marrë dijeni dhe nuk ka ndërmarrë asnjë veprim ndaj subjektit “Kamelja 3”.

Përveç shkeljeve të konstatuara në subjektin Kamelja 3, në Raportin e Auditimit rezultojnë shkelje edhe në inspektimet e kryera pranë disa subjekteve të tjera, si subjekti Luan Vogli, subjektin Furrë Buke, me përfaqësues A.P. dhe subjektin supermarket Extramarket Bashkia Durrës.

Znj. L.K. e ka ankimuar aktin e sipërpërmendur pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës. Gjykata është shprehur me vendimin nr. 82-2018-1224 830, datë 21.12.2018, nëpërmjet së cilit e ka rrëzuar kërkesë-padinë e Znj. L.K.. Në vijim, ankuesja e ka ankimuar vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

Komisioneri ka konstatuar faktin se në Vendimin nr. 4285/5, datë 03.09.2018, e Komisionit Disiplinor, në njërin prej rasteve ku janë konstatuar shkelje, përgjegjësia për njërin prej shkeljeve të konstatuara i është lënë ankueses, pasi është theksuar fakti se ajo ka qenë Koordinatorja e sektorit të OJSH-së. Kështu, referuar vendimit të sipërpërmendur, në Rubrikën “Argumentimi Ligjor”, në lidhje me subjektin Furrë Buke, me përfaqësues A.P. citohet: “Nëpunësja L.K., e cila mbulon dhe pozicionin e koordinatorit për Sektorin OJSH të DRAKU Durrës, (pra personi i cili përpilon planin e punës dhe e dërgon për miratim) nuk e ka reflektuar apo propozuar këtë subjekt Drejtorit Rajonal, që ta përfshijë në planin e punës. Një gjë e tillë/paligjshmëri në veprim, ka vazhduar edhe pas inspektimit të subjektit mbi bazën e indicies/demoncimit të adresuar në këtë drejtori, ku pas kryerjes së veprimeve inspektuese janë konstatuar mangësi të theksuara të kërkesave ligjore”. Ndërkohë që, po t’i referohem shkresës nr.16/2, datë 06.02.2019, të DRAKU Durrës, ku jepen sqarime për pozicionin e koordinatorit, sqarohet se: “Ky pozicion nuk bën pjesë në organikën e këtij institucioni. Ky pozicion rregullohet me një vendim të titullarit të institucionit, por gjithnjë me pëlqimin e punonjësit përkatës. Në arshivën e institucionit të DRAKU Durrës nuk është gjendur një dokument i brendshëm për

*caktimin e Znj. L.K. në këtë pozicion.*” Në seancë dëgjimore, përfaqësuesit e AKU-së dhe DRAKU-t Durrës, sqaruan se pozicioni Koordinator, nuk ishte i përcaktuar në strukturën organike të DRAKU-t Durrës, si dhe nuk ekziston asnjë urdhër i brendshëm i Drejtorit të DRAKU-t Durrës, për të emëruar nominalisht Znj. L.K. si koordinatorë të inspektorëve. Koordinatori ka qenë një pozicion i krijuar në fillesat e institucionit, por që prej 5 vitesh nuk ekziston më si i tillë në strukturën organike. Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se hartimi i planeve të punës dhe dërgimi i tyre për miratim, ka qenë një detyrë që i është ngarkuar nga titullari dhe e ka kryer Znj. L.K., por jo sepse ajo ka patur nominalisht një emërtësë “Koordinatorë”.

Komisioni Disiplinor i AKU-së ka konkluduar me dhënien e masës disiplinore “*largim nga shërbimi civil*” për inspektoren L.K., duke zbatuar edhe nenin 50, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, ku përcaktohen parimet për përshkallëzimin dhe individualizimin e masës disiplinore. Ndaj ankueses ekzistonte dhe ishte në fuqi edhe një masë e mëparshme disiplinore, e cila është lënë në fuqi edhe nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë. Shkeljet e evidentuara që konsistojnë në “*mospërbushjen e rëndë të detyrave*” dhe “*moszbatimi haptazi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale*”, parashikuar nga neni 57, pika 2, gërmat a) dhe c) të ligjit të sipërpërmendur klasifikohen si shkelje shumë të rënda, që sjellin pasoja shumë të rënda në aspektin e cënimit të sigurisë ushqimore.

Komisioneri ka konstatuar gjithashtu se masa disiplinore, në të njëjtën periudhë kohore, janë marrë edhe ndaj disa inspektorëve të tjerë, që kanë qenë në grupet e inspektimit bashkë me ankuesen. Nëpërmjet Vendimit nr. 4340/5, datë 03.09.2018, Komisioni Disiplinor i AKU-së ka marrë masën disiplinore “*largim nga shërbimi civil*” për inspektorin D. Z., i cili ka qenë në grup inspektimi me Znj. L.K.. Nëpërmjet Vendimit nr. 4341/5, datë 12.09.2018, Komisioni Disiplinor i AKU-së ka marrë masën disiplinore “*mbajtje 1/3 e pagës së plote për një periudhë 1 muaj*” për inspektorin A. B. Nëpërmjet Vendimit nr. 4339/5, datë 12.09.2018, Komisioni Disiplinor i AKU-së ka marrë masën disiplinore “*mbajtje 1/3 e pagës së plotë, për një periudhë 1 muaj*”, për inspektorin M. Ç. Nëpërmjet Vendimit nr. 4440/5, datë 03.09.2018, Komisioni Disiplinor i AKU-së ka marrë masën disiplinore “*Pezullim nga drejta e ngritjes në detyrë përfshirë shkallën e pagës për një periudhë 2 vite*”, për inspektorin D. D.

Në kontekstin e mësipërm, Komisioneri gjykon se Znj. L.K. nuk i është ekspozuar një trajtimi të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së dhe Drejtorisë Rajonale të AKU-së, Durrës. Në mungesë të një trajtimi të tillë, nuk ekziston diskriminim, për shkakun e pretenduar në ankesë.

**III.** Lidhur me pretendimin e ankueses se ajo ka qenë e vetmja inspektore femër, që është caktuar në grupin e inspektimit, DRAKU Durrës ka sqaruar se Sektori i Inspektimit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshë me Origjinë Joshtazore dhe Operatorët e Biznesit ka në përbërje të tij 4 (katër) inspektore femra, ndër të cilat një inspektore femër ka qenë me leje lindjeje, një inspektore tjetër ka qenë e ngarkuar me punë pranë Sektorit të Shërbimeve të Brendshme, në zbatim të Urdhërit nr. 109/3, Prot., datë 06.02.2017, të

Drejtorit të DRAKU Durrës, si dhe inspektorja e tretë femër ka qenë e ngarkuar pranë Sektorit të Shërbimeve Laboratorike, nëpërmjet Urdhërit nr. 426 prot., datë 06.03.2018, të Drejtorit të DRAKU Durrës. Për këtë pretendim, Komisioneri gjykon se ankuesja ka nënkuptuar diskriminim të saj për shkak të gjinisë dhe vlerësimi i tij do të jepet në këtë kontekst.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se në kushtet kur, inspektorët e tjera femra nuk kanë qenë të disponueshme për shkaqet e mësipërme, të cilat janë të provuara nga DRAKU Durrës, Znj. L.K. nuk është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë e disfavorizues nga DRAKU Durrës. Në mungesë të një trajtimi të tillë, Komisioneri vlerëson se nuk ekziston diskriminim për shkak të gjinisë, së ankuses nga ana DRAKU Durrës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së.

**IV.** Lidhur me pretendimin e Znj. L.K., që inspektimet gjatë sezonit turistik, janë kryer gjatë ditëve të fundjavës, në shkresën e DRAKU, Qarku Durrës, sqarohet se, këto inspektime janë kryer në zbatim të Urdhërit nr. 07, datë 30.04.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të AKU-së. Sipas këtij urdhëri, inspektorët do të punojnë edhe gjatë ditëve të shtuna dhe të djela, si dhe jashtë kohës normale të punës<sup>8</sup>, për të përballuar fluksin e rritur të kontrolleve në të gjitha subjektet, veçanërisht të vijës bregdetare. Në këtë urdhër përcaktohet gjithashtu se për inspektimet që do të kryhen ditët e pushimeve, por edhe jashtë kohës normale të punës, do të këtë urdhër të veçantë nga Drejtori Rajonal, duke përcaktuar specifikisht inspektorët dhe subjektet që do të inspektohen<sup>9</sup>. Komisioneri gjykon se çështja e sigurisë ushqimore, në lokalet dhe restorantet e vijës bregdetare, sidomos gjatë periudhës turistike në muajt e verës është një çështje tepër e rëndësishme. Drejtori i DRAKU Durrës ka vepruar në bazë të një urdhëri, të një institucioni epror. Ky urdhër i përfshin të gjithë inspektorët e DRAKU Durrës dhe jo vetëm Znj. L.K..

Në zbatim të urdhërit të mësipërm, inspektimet janë kryer në bashkëpunim ndërmjet sektorit OJSH dhe OSH të DRAKU Durrës dhe grupet e inspektimit koordinoheshin çdo javë. Lidhur me kompensimin e orëve e punës të kryera jashtë orarit zyrtar, DRAKU Durrës ka zbatuar parashikimin e pikës 5, Kreu I, të Vendimit nr. 511, datë 24.10.2002, të Këshillit të Ministrave, *“Për kohëzgjatjen e punës dhe pushimit në institucionet shtetërore”* (të ndryshuar).

Në kontekstin e mësipërm, Komisioneri gjykon se Znj. L.K. nuk i është ekspozuar një trajtimi të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së dhe Drejtorisë Rajonale të AKU-së, Durrës. Në mungesë të një trajtimi të tillë, nuk ekziston diskriminim, për shkakun e pretenduar në ankesë.

<sup>8</sup> Pika 8, e Urdhërit nr. 07, datë 30.04.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të AKU-së;

<sup>9</sup> Pika 9, e Urdhërit nr. 07, datë 30.04.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të AKU-së.

## **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 12, 13 e 15, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pika 4, gërma dh), si dhe pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## **V E N D O S I :**

- 1.** Konstatimin e mosdiskriminimit të Znj. L.K., për shkak të moshës dhe gjinisë, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së dhe Drejtorisë Rajonale të AKU-së, Durrës.
- 2.** Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Robert GAJDA**

---

**KOMISIONERI**

Fusha –punësim  
Shkak- mosha